



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Urbanizmit
Periudha raportuese	Prill, 2019
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Ardian Olluri, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit

1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, ka vazhduar aktivitetet për udhëheqjen e procedurave administrative për trajtimin e kërkesave të shumta të palëve, në kuadër të dy sektorëve, Sektorit të urbanizmit dhe Sektorit të legalizimit, si dhe të Zyrës së adresave.

Sektori i urbanizmit, ka vazhduar me mbajtjen e takimeve të rregullta të mëngjesit me grupet e caktuara të zyrtarëve, ku është diskutuar për raportin javor të punës, si dhe për aktivitetet e planifikuara për javën pasuese.

Po ashtu, është vazhduar me mbajtjen e takimeve të Kolegjiumit (grup i formuar nga zyrtarë të caktuar), për konsultim dhe shqyrtim të kërkesave specifike, sipas kërkesave të zyrtarëve, si dhe janë caktuar grupe të zyrtarëve të Drejtorisë për dhënien e mendimeve profesionale për çështje që kanë të bëjnë me Sektorin e urbanizmit.

Gjatë këtij muaji janë pranuar gjithsejtë 168 kërkesa të ndryshme. Në këtë periudhë raportuese janë përfunduar gjithsejtë 133 kërkesa.

Zyra e Adresave, po ashtu ka vazhduar punën në kryerjen e aktiviteteve ditore të tyre, mbajtjen e takimeve me palë, si dhe me shqyrtimin dhe përfundimin e kërkesave të pranuar, që kanë të bëjnë me emërtim të rrugëve, caktim të adresës dhe numrit të shtëpisë etj.

Gjatë muajit prill 2019, është vazhduar me trajtimin dhe përmbylljen e kërkesave të shumta, të pranuar gjatë kësaj periudhe raportuese.

Sektori i legalizimit, procesi i legalizimit është pezulluar që nga data 15.02.2017, nuk ka pasur ndonjë aktivitet madhor dhe te ndryshëm nga muajt tjerë, megjithatë janë paraqitur kërkesa prej më të ndryshmeve, siç janë: informata, kërkesa për qasje në dokumente zyrtare etj.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me plan programin e Komunës për drejtorinë tuaj .

Aktivitetet e planifikuara të Drejtorisë së Urbanizmit, për muajin vijues, janë:

Sektori i urbanizmit dhe Zyra e adresave

- Vazhdimin e shqyrtimit të lëndëve për caktim të kushteve ndërtimore, për leje ndërtimore, për leje të rrënimin, për certifikatë/leje përdorimi, për dhënien e pëlqimit për bashkim/ndarje të parcelave kadastrale, për dhënien e pëlqimit paraprak shpronësim/kompensim/këmbim, për miratim të ndryshimeve të projektit kryesor, për korrigjim të akteve juridike, për qasje në dokumente zyrtare, për emërtim të rrugës apo caktim të adresës, për rishqyrtim të lëndëve, për ankesat e ndryshme të palëve, e kërkesave tjera, duke zbatuar rregullativën ligjore në fuqi;
- Kolegjiumi do të vazhdojë me punën për konsultimin dhe shqyrtimin e kërkesave dhe çështjeve të tjera;
- Do të vazhdojmë me pranim në takim të qytetarëve të interesuar, për t`u konsultuar lidhur me propozimet për zgjidhje urbane, për dhënien e informatave lidhur me procedurat e aplikimit për caktim të kushteve ndërtimore, leje ndërtimore dhe për kërkesa të tjera;
- Janë planifikuar vizita zyrtare në terren për të gjitha kërkesat e paraqitura në vazhdimësi;
- Do të vazhdohet me procesin e dërgimit të kërkesave në KEDS dhe KUR, përmes postës elektronike, për marrjen e pëlqimeve përkatëse për caktimin e kushteve teknike për kyçje në infrastrukturë, sipas marrëveshjes së arritur, sipas sistemit “One Stop Shop”;
- Do të vazhdohet me procesin e dërgimit të kërkesave në Drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, për arritjen e marrëveshjes për infrastrukturë, në mes të kësaj drejtorie dhe pronarit/investitorit, si dhe dërgimit të kërkesave në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, për marrjen e pëlqimit për masat e mbrojtjes kundër zjarrit, sipas marrëveshjes së arritur, sipas sistemit “One Stop Shop”;
- Do të vazhdohet me mbikëqyrjen e punëve për realizimin e kontratës “Furnizimi dhe vendosja e tabelave me emra të rrugëve në komunën e Prishtinës” dhe “Furnizimi dhe vendosja e numrave të adresave në komunën e Prishtinës”;
- Do të vazhdohet me zbatimin e orarit të ri të punës në sportelin e kësaj drejtorie, duke ofruar shërbim për palë, brenda tërë orarit të punës (sporteli i zhvendosur në katin përdhes të ndërtesës), dhe duke vazhduar me dorëzim/pranimin e akteve juridike dhe shkresave tjera reale, aplikuesve, dhe në rast të mosparaqitjes së aplikuesve në sportel, dërgimi i tyre përmes shërbimit postar;
- Do të vazhdohet me procesin e publikimit të vendimeve të kushteve ndërtimore-si fazë e parë e ndërtimit, dhe lejeve ndërtimore, si fazë e dytë e ndërtimit, në faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës;
- Do të vazhdohet me regjistrimin dhe publikimin e kërkesave/lëndëve në sistem “Sistemi i vrojtimit të lejeve”, në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Prishtinës, bazuar në UA 06/2017;
- Do të vazhdohet me vendosjen në terren të Njoftimit publik dhe publikimin e këtij njoftimi (paraprakisht caktimit të Kushteve ndërtimore), në faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës, bazuar në UA 06/2017;

- Do të vazhdohet me publikimin e komenteve të pranuar brenda periudhës së Njoftimit publik”, bazuar në UA 06/2017:
- Do të vazhdohet me publikimin e përgjigjeve lidhur me komentet e pranuar gjatë periudhës së Njoftimit publik, bazuar në UA 06/2017;
- Vazhdimi i procesit të digjitalizimit të dokumentacionit të arkivit/lëndëve të Sektorit të urbanizmit, si proces i përhershëm, i cili ka të bëjë me skanimin e lëndëve fizike, sistemimin e tyre në formë elektronike në hapësirën elektronike të ndarë enkas për arkiv digjital, si dhe përcjellja elektronike e tyre te aplikuesit, te personat fizikë dhe juridikë;
- Sistemimi i projekteve kryesore, në arkivin e përkohshëm të drejtorisë;
- Propozimi për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente zyrtare nga personat e trajnuar për këtë detyrë.

Spektori i legalizimit

- Përgatitjet intensive teknike-hapësinore, ndarja e kuadrit që do të sistemohen në këtë sektor për rifillimin e procesit të legalizimit-trajtimin e ndërtimeve pa leje, pezullimet e kërkesave që nuk e kanë tërhequr vendimin për pagesën e taksave, në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit.

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.

Në vazhdim janë të listuara aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese, dhe ato në implementim e sipër, si:

- Spektori i urbanizmit dhe Zyra e adresave:

- Konsultimi dhe shqyrtimi i kërkesave, dhe diskutimi dhe vendosja për çështje tjera të drejtorisë nga Kolegjiumi;
- Janë mbajtur takime me qytetarë të interesuar, për t`u konsultuar lidhur me propozimet për zgjidhje urbane, për dhënien e informatave lidhur me procedurat e aplikimit për caktim të kushteve ndërtimore, leje ndërtimore dhe për kërkesa të tjera;
- Janë realizuar vizitat e zyrtarëve në terren, për të gjitha kërkesat në procedurë;
- Vendosja e njoftimeve publike në terren në të gjitha rastet e kërkesave për kushte ndërtimore;
- Trajtimi i të gjitha komenteve/ankesave të pranuar gjatë periudhës së njoftimit publik;
- Është vazhduar me procesin e dërgimit të kërkesave në KEDS dhe KUR, përmes postës elektronike, për marrjen e pëlqimeve përkatëse për caktimin e kushteve teknike për kyçje në infrastrukturë, sipas marrëveshjes së arritur, sipas sistemit “One Stop Shop”;
- Është vazhduar me procesin e dërgimit të kërkesave në Drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, për arritjen e marrëveshjes për infrastrukturë, në mes të kësaj drejtorie dhe pronarit/investitorit, si dhe dërgimit të kërkesave në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, për marrjen e pëlqimit për masat e mbrojtjes kundër zjarrit, sipas marrëveshjes së arritur, sipas sistemit “One Stop Shop”;

- Është vazhduar me mbikëqyrjen e punëve për realizimin e kontratës “Furnizimi dhe vendosja e tabelave me emra të rrugëve në komunën e Prishtinës” dhe “Furnizimi dhe vendosja e numrave të adresave në komunën e Prishtinës”;
- Është bërë regjistrimi dhe publikimi i kërkesave/lëndëve në sistem “Sistemi i vrojtimit të lejeve”, në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Prishtinës, bazuar në UA 06/2017;
- Është vazhduar me zbatimin e orarit të ri të punës, në sportelin e kësaj drejtorie, duke ofruar shërbim për palë, vetëm 2 (dy) orë brenda orarit të punës, dhe duke vazhduar me dorëzim/pranimin e akteve juridike dhe shkresave tjera reale, aplikuesve, dhe në rast të mosparaqitjes së aplikuesve në sportel, dërgimi i tyre përmes shërbimit postar;
- Vazhdimi i procesit të digjitalizimit të dokumentacionit të arkivit/lëndëve të Sektorit të urbanizmit, si proces permanent i cili ka të bëjë me skanimin e lëndëve fizike, sistemimin e tyre në formë elektronike në hapësirën elektronike të ndarë enkas për arkiv digjital;
- Sistemimi i projekteve kryesore, në arkivin e përkohshëm të drejtorisë.

Si të arritura të Drejtorisë së Urbanizmit, për këtë periudhë raportuese, vlerësohet të jenë:

- Publikimi i Njoftimit publik, komenteve të pranuar brenda periudhës së Njoftimit publik, si dhe përgjigjet lidhur me komentet e pranuar gjatë kësaj periudhe, në faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës, procedurë kjo e paraparë sipas UA 06/2017, para caktimit të Kushteve ndërtimore;
- Inicimi i procedurës për publikimin e vendimeve për caktimin e kushteve ndërtimore, si fazë e parë e ndërtimit, në faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës.
- Sistemimi i projekteve kryesore në arkivin e përkohshëm të drejtorisë.

Spektori i legalizimit

- Ndarja e resurseve njerëzore-profesionale, si dhe përgatitjet për rifillimin e procesit të legalizimit – trajtimin e ndërtimeve pa leje;
- Pezullimi i kërkesave – lëndëve, për të cilat janë nxjerrë aktvendimet për caktim të taksës për pagesë, e që palët nuk i kanë tërhequr fare.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR – Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.

Në Drejtorinë e Urbanizmit janë në vazhdim e sipër aktivitetet ditore, për:

Spektori i urbanizmit dhe Zyra e adresave:

- Shqyrtimin dhe vendosjen për të gjitha kërkesat e pranuar nga palët e caktuara, duke u përkushtuar në respektimin e afateve ligjore;
- Pranimin e palëve në takime për dhënie të informatave të ndryshme, sipas kërkesave të tyre;
- Realizimin e vizitave në terren;
- Vazhdimin e procesit të dërgimit të kërkesave në Drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, për arritjen e marrëveshjes për infrastrukturë, në mes të kësaj

drejtorie dhe pronarit/investitorit, si dhe dërgimit të kërkesave në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, për marrjen e pëlqimit për masat e mbrojtjes kundër zjarrit, sipas marrëveshjes së arritur, sipas sistemit “One Stop Shop”;

- Vazhdimin e mbikëqyrjes së punëve për realizimin e kontratës “Furnizimi dhe vendosja e tabelave me emra të rrugëve në komunën e Prishtinës” dhe “Furnizimi dhe vendosja e numrave të adresave në komunën e Prishtinës”;
- Skanimin e lëndëve të përfunduara dhe sistemimin e tyre në arkivin e drejtorisë;
- Publikimin e vendimeve të lejeve ndërtimore në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Prishtinës;
- Inicimin e procedurës për publikimin e vendimeve të kushteve ndërtimore, si fazë e parë e ndërtimit, në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Prishtinës;
- Regjistrimin e kërkesave/lëndëve në sistem “Sistemi i vrojtimit të lëndës”, në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Prishtinës;
- Vazhdimin e procedurës për publikimin e Njoftim publik, komenteve të pranuar brenda periudhës së Njoftimit publik, si dhe përgjigjet lidhur me komentet e pranuar gjatë kësaj periudhe në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Prishtinës, procedurë kjo e paraparë sipas UA 06/2017, para caktimit të Kushteve ndërtimore,
- Vazhdimin e procesit të digjitalizimit të dokumentacionit të arkivit/lëndëve të Sektorit të Urbanizmit, si proces permanent, i cili ka të bëjë me skanimin e lëndëve fizike, sistemimin e tyre në formë elektronike në hapësirën elektronike të ndarë enkas për arkiv digjital;
- Sistemimin e projekteve kryesore, në arkivin e përkohshëm të drejtorisë.

Sektori i legalizimit

- [Pezullimi i kërkesave – lëndëve, për të cilat janë nxjerrë aktvendimet për caktim të taksës për pagesë, e që palët nuk e kanë bërë tërheqjen e tyre,](#)

4.1.1. STATISTIKAT-Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të këtë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

Sektori i urbanizmit dhe Zyra e adresave

Takime me palë	Takime me institucion e/drejtori tjera	Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare	Kërkesa të pranuar	Të përfunduara	Në përfundim e sipër
220	11	0	168	133	138

- Numri i kërkesave të pranuar/kërkesa të reja.....168

• Aktpërcjellës.....	22
• Ankesa.....	7
• Bashkim i parcelave.....	0
• Caktim i lokacioneve.....	0
• Caktim i pikave.....	9
• Kërkesave për zyrën e adresave.....	25
• Kërkesa të ndryshme (<i>për ndërtim të ashensorit, për zhvendosje të njehsorëve, për pëlqim për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore, për informata, për koordinata të vijës ndërtimore dhe rregulluese, për shtyrje të afatit, për vazhdim të afatit të vlefshmërisë së vendimit, për emërtim të rrugës, për vendosje të numrit, për njoftim për fillim të punimeve etj.</i>)	19
• Kushte, kategoria I.....	20
• Kushte, kategoria II.....	4
• Leje për rrugë.....	0
• Leje, kategoria I.....	6
• Leje, kategoria II.....	13
• Leje përdorimi.....	6
• Leje rrënimi.....	5
• Ndërrim destinimi.....	7
• Njoftim.....	4
• Objekt i përkoshëm.....	0
• Parcializim.....	0
• Plotësim/ndryshim i projektit.....	3
• Plotësim/ndryshim i kushteve.....	2
• Plotësim/ndryshim i lejes.....	2
• Qasje në dok. zyrtare.....	0
• Renovim.....	3
• Riaplikim.....	0
• Rishqyrtim i lëndës.....	4
• Vërtetim dëme lufte.....	0
• Kërkesa për koordinata.....	4
• Përgjigje.....	3

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë trajtuar gjithsejtë 111 kërkesa/lëndë, dhe janë nxjerrë akte juridike dhe shkresat tjera reale, si në vijim:

• Vendim mbi caktimin e kushteve ndërtimore-kat. I.....	13
• Vendim mbi caktimin e kushteve ndërtimore-kat. II.....	5
• Vendim për leje ndërtimore-kat. I.....	6
• Vendim për leje ndërtimore-kat. II.....	3
• Aktvendim mbi caktimin e taksës administrative dhe tarifës për densitet.....	5
• Vendim për leje të rrënimimit.....	3
• Aktvendim mbi caktimin e taksës administrative për leje rrënimi.....	5
• Vendim i lejes së përdorimit.....	2
• Vendim mbi refuzimin e kërkesës.....	22
• Vendim mbi pezullimin e procedurës.....	2
• Vendim mbi përfundimin e procedurës.....	0
• Vendim mbi shtyrjen e afatit të shqyrtimit të kërkesës.....	0

• Vendim për miratim të ndryshimeve të projektit kryesor/korrigjim të vendimeve.....	4
• Vendim/pëlqim për lejim të zhvillimit të punimeve.....	1
• Konstatim mbi caktimin e pikave.....	12
• Pëlqim për bashkim/ndarje të parcelave.....	1
• Njoftime publike për kushte ndërtimore.....	9
• Informime.....	20
• Vendosur në lëndën bazë, pas përfundimit me vendim përkatës.....	5
• Leje për rrugë.....	0
• Pëlqime	16
• Aktpërcjellës.....	13
• Plotësime.....	16
• Vërtetime.....	9
• Aktpërcjellës në:	
- MMPH, dërgim në kompetencë i ankesës së palës.....	1
- D. KADASTRIT, në kopmetencë.....	6
- D. INVESTIME KAPITALE.....	28
- Institucione të tjera	5

Spektori i legalizimit

○ Kërkesa për informacion lidhur me legalizim dhe rreth procedurës.....	0
○ Takimi i palëve për informacion, me komunikim të drejtpërdrejtë.....	0

4.1.2 Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese

Drejtoria e Urbanizmit-Spektori i urbanizmit nuk shpenzon buxhet. Kjo drejtori realizon të hyra nga taksat për leje të ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës dhe nga taksa administrative për leje të rrënitimit, bazuar në Rregulloren mbi taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës, 01. nr. 434/01–0094474/17, dt. 24.04.2017.

Në këtë periudhë raportuese janë realizuar të hyrat buxhetore në vlerë prej **785,309.70 €**, nga taksa administrative për leje të ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, si dhe nga taksa administrative për leje të rrënitimit.

Si buxhet i shpenzuar llogaritet realizimi i dy kontratave “Furnizimi dhe vendosja e tabelave me emra të rrugëve në Komunën e Prishtinës” dhe “Furnizimi dhe vendosja e numrave të adresave në Komunën e Prishtinës”, të cilat janë në proces të realizimit që nga viti paraprak.

4.1.3 Takimet me palë

Drejtoria e Urbanizmit-Spektori i urbanizmit, ka mbajtur takime të rregullta me palë, çdo të martë dhe të enjte, prej orës 9.00 deri në 12.00. Në këtë periudhë janë pranuar në takime rreth

220 palë të interesuara, për t`ju dhënë informata për procesin e trajtimit të kërkesave të tyre në procedurë, apo edhe informata tjera, lidhur me: procedurat e pajisjes me kushte ndërtimore, leje ndërtimore, leje rrënimi, certifikata të përdorimit, qasje në dokumente zyrtare, me procedurat për përfundimin e procesit të ndarjes dhe bashkimit të parcelave, të shpronësimit/kompensimit apo këmbimit të tyre, etj.

Spektori i legalizimit

- Takimi i palëve për informacion, me komunikim të drejtpërdrejtë.....0

5. Takimet me institucione të tjera

5.1.1 *Diskutime publike/takimet me qytetarë* - Nuk kemi pasur.

6. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

Nuk janë pranuar kërkesa për qasje në dokumente zyrtare, përpos me formën elektronike.

6.1.1 *Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër*

Gjatë muajit raportues janë pranuar gjithsejtë 168 kërkesa të reja, prej tyre janë përfunduar 50 lëndë dhe në përfundim e sipër janë 118.

7. *Takime të tjera* - nuk ka.

8. *SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.*

Sfidë për Drejtorinë e Urbanizmit në të ardhmen mbetet fillimi i përgatitjeve për procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje, dhe përballimi i këtij procesi, pas miratimit të ligjit përkatës, duke pasur parasysh mungesën e stafit, mungesën e hapësirës për punë etj., angazhimi i të gjithëve, për respektimin e afatit të përcaktuar ligjor, për përfundimin e kërkesave të palëve, e po ashtu sfidë tjetër mbetet gjetja e metodave për vetëdijesim të qytetarëve që të pajisen me Leje përdorimi/Certifikatë të përdorimit për ndërtesat që paraprakisht janë pajisur me leje ndërtimi, si dhe për legalizimin e ndërtimeve pa leje.

9. *REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë etj.*

Spektori i urbanizmit dhe Zyra e adresave

- Të mundësohen trajnime për zyrtarë;
- Të mundësohen vizita zyrtare të stafit në vendet e rajonit, për të shkëmbyer përvojat e praktikuara në procesin e pajisjes me leje ndërtimore.

Sektori i Legalizimit

- Të sigurohet numri i zyrtarëve-profesionistë në kohën kur po vjen afati për riaplikim – trajtim, sfidat që presin ekipin tonë të zyrtarëve janë bukur të mëdha dhe se kërkon staf të përgatitur mirë në aspektin profesional;
- Trajnimi i stafit sipas konditave dhe standardeve më të reja, të cilat do të aplikohen në përdorimin e programit të caktuar-të avancuar, për aplikim-trajtim të kërkesave në trajtim të ndërtimeve pa leje, në bashkëpunim me MMPH.

10. *AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES-Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues*

Aktivitetet e planifikuara të Drejtorisë së Urbanizmit, për muajin pasues, janë:

Sektori i urbanizmit dhe Zyra e adresave

- Zbatimi i rregullativës ligjore në fuqi dhe afateve ligjore të përcaktuara në procedurën e shqyrtimit dhe të vendosjes për kërkesat për caktim të kushteve ndërtimore, për leje ndërtimore, për leje të rrënitimit, për certifikatë/leje përdorimi, për dhënien e pëlqimit për bashkim/ndarje të parcelave kadastrale, për dhënien e pëlqimit paraprak shpronësim/kompensim/këmbim, për miratim të ndryshimeve të projektit kryesor, për korrigjim të akteve juridike, për qasje në dokumente zyrtare, për emërtim të rrugës apo caktim të adresës, për rishqyrtim të lëndëve, për ankesat e ndryshme të palëve, e kërkesave tjera;
- Zbatimi i rregullave të vendosura dhe qëndrimeve të marra, në takimet e mbajtura me drejtoritë komunale dhe ministritë përkatëse, lidhur me lehtësimin e procedurave administrative në procesin e pajisjes me leje ndërtimore, si në aspektin eliminimit të procedurave të panevojshme, po ashtu edhe në reduktimin e kohës së nevojshme për përfundimin e atij procesi;
- Riorganizimi i punës në Zyrën shërbyese/One Stop Shop, e cila funksionon në kuadër të Sektorit të urbanizmit të kësaj drejtorie;
- Konsultimi dhe shqyrtimi i kërkesave, dhe çështjeve tjera, nga Kolegjiumi;
- Mbajtja e takimeve me qytetarë të interesuar, për t'u konsultuar lidhur me propozimet për zgjidhje urbane, për dhënien e informatave lidhur me procedurat e aplikimit për caktim të kushteve ndërtimore, leje ndërtimore dhe për kërkesa tjera;
- Organizimi i takimeve me zyrtarë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, për të diskutuar dhe vendosur për lehtësimin e procedurave dhe reduktimin e kohës, në procesin e pajisjes me leje ndërtimore;
- Realizimi i vizitave në terren;
- Vazhdimi i procesit të dërgimit të kërkesave në KEDS dhe KUR, përmes postës elektronike, për marrjen e pëlqimeve përkatëse për caktimin e kushteve teknike për kyçje në infrastrukturë, sipas marrëveshjes së arritur, sipas sistemit “One Stop Shop”;
- Vazhdimi i procesit të dërgimit të kërkesave në Drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, për arritjen e marrëveshjes për infrastrukturë, në mes të kësaj drejtorie dhe pronarit/investitorit, si dhe dërgimit të kërkesave në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, për marrjen e pëlqimit për masat e mbrojtjes kundër zjarrit, sipas marrëveshjes së arritur, sipas sistemit “One Stop Shop”;

- Vazhdimi i mbikëqyrjes së punëve për realizimin e kontratës “Furnizimi dhe vendosja e tabelave me emra të rrugëve në Komunën e Prishtinës” dhe “Furnizimi dhe vendosja e numrave të adresave në Komunën e Prishtinës”.
- Përgatitja i njoftimit publik për qytetarë, për publikimin në faqen zyrtare të Komunës, të regjistrit të kërkesave të përfunduara, të cilat janë konsideruar si të braktisura, për shkak të mosinteresimit të palës;
- Vazhdimin e procedurës për publikimin e Njoftimeve publik, paraprakisht caktimit të Kushteve ndërtimore, në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Prishtinës, bazuar në UA 06/2017;
- Vazhdimin e procedurës për publikimin e komenteve të pranuar brenda periudhës së Njoftimit publik”, bazuar në UA 06/2017;
- Vazhdimin e procedurës për publikimin e përgjigjeve lidhur me komentet e pranuar gjatë periudhës së Njoftimit publik”, bazuar në UA 06/2017;
- Publikimi i vendimeve të kushteve ndërtimore, në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Prishtinës;
- Publikimi i vendimeve të lejeve ndërtimore, në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Prishtinës;
- Regjistrimi dhe publikimi i kërkesave/lëndëve në sistem “Sistemi i vrojtimit të lejeve”, në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Prishtinës, bazuar në UA 06/2017;
- Vazhdimi i procesit të digjitalizimit të dokumentacionit të arkivit/lëndëve të Sektorit të Urbanizimit, si proces permanent i cili ka të bëjë me skanimin e lëndëve fizike, sistemimin e tyre në formë elektronike në hapësirën elektronike të ndarë enkas për arkiv digjital;
- Sistemimi i projekteve kryesore, në arkivin e përkohshëm të drejtorisë.

Sektori i legalizimit

- **Kontakti i përhershëm me përfaqësues të USAID-së, OJQ e autorizuar për takim dhe realizim të “pilot-projektit” me Komunën e Prishtinës , së bashku me MMPH-në, rreth monitorimit dhe ndihmës dhënë këtyre komunave për përgatitjen sa më të mirë gjatë procesit të legalizimit.**

11. TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme

12. Sektori i legalizimit:

Meqenëse aprovimi i Ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje është gati dhe së shpejti pritet aprovimi edhe i UA, aktiviteti ynë është në rregullimin e dokumentacionit për lëndët që janë të përfunduara me vendim për legalizim, si dhe pezullimi i atyre kërkesave që nuk e kanë bërë tërheqjen e vendimeve për taksa administrative.